



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 30.01.2023,  
duke filluar në orën 10:00.

**Në mbledhje morën pjesë:** Fehmi Kupina, kryesues i komitetit, anëtarët e komitetit: Arbnora Berisha, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi, Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Leutrim Retkoceri, Shëgë Beqiri, Bahri Gashi dhe Mirsad Vitia.

**Mungoi:** Donjeta Dragusha.

**Në mbledhje ishin të pranishëm edhe:** Alban Zogaj, nënkryetari i Komunës, Valbona Ahmeti - Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Osman Bllaca, Arben Kçira, udhëheqës i Zyrës ligjore, dhe Premtime Preniqi, koordinatorë për të drejtat e njeriut.

Mbledhjen e hapoi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues.

Para së të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, **Gëzim Sveçla** propozoi që të futen si pika të rendit të ditës "Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit, nr. 01-202/02-10355516/22, dt.12.05.2022, për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës" dhe "Diskutim për çështjen e tatimit në pronë dhe propozimvendim për rekomandime ndaj qeverisë së Republikës së Kosovës".

**Osman Bllaca** sugjeroi të jetë pika "Diskutim për çështjen e tatimit në pronë", e në bazë të diskutimit i nxjerrim rekomandimet.

**Valbona Makolli - Ahmeti** propozoi që të futet në rend dite "Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", SHA në Prishtinë".

**Leutrim Retkoceri** propozoi që të formohet komisioni për emërtim dhe riemërtim të rrugëve, në mënyrë që për seancën tjetër të futet në plan të punës. Këtë herë të plotësohet, ndërsa për seancën e ardhshme besoj që janë gati me dokumente që të vazhdojmë me formimin e këtij komisioni.

Sa i përket çështjes së rritjes së tatimit në pronë, qytetarët e kanë të nevojshme ta dinë se si ka ardhur puna e rritjes së tatimit, çka ka ndodhur me pronat e tyre, çka ka ndodhur me normat, që është përgjegjësi e Komunës, kështu që dikush nga zyrtarët e Zyrës së Tatimit në Pronë do të duhej të vinte për të dhënë sqarim. Duhet ditur edhe ne si Kuvend se çfarë ka ndodhur me atë pikë, a iu ka kthyer Ministrisë së Financave apo është vendosur siç e parasheh ligji, që në mënyrë automatike hyn në fuqi ai vlerësim pavarësisht votimit të Kuvendit.

Faqe1nga8

Andaj, mendoj që kjo pikë duhet të jetë "Informatë mbi rritjen e tatimit në pronë".

**Gëzim Sveçla** tha se informata nuk votohet, qëllimi ynë është të votohet rekomandimi në fund të atij diskutimi që ndodh, te informata nuk ka votim.

**Alban Zogaj** shprehu mendimin se kemi pajtim që tema e tatimit të diskutohet dhe mund ta quajmë informatë, diskutim dhe rekomandime potenciale, por i diskutojmë të gjitha këto tema në seancë dhe me votë vendosim se si të vazhdojmë tutje dhe çfarë rekomandojmë, sepse rekomandimet do të dalin nga diskutimi dhe mbledhja.

Ne duhet të përgatitemi si grupe politike për të dhënë rekomandimet tona mandej i votojmë, voton asambleja, dhe në bazë të votave i dërgojmë rekomandimet. Diçka duhet ndërmarrë gjithsesi, sepse jemi para një akti të kryer dhe para një shqetësimi të qytetarëve të Prishtinës dhe konsiderojmë që kjo duhet me gjetur një rrugë të veten urgjent.

**Leutrim Retkoceri** tha se ne i kemi argumentet tona pse duhet të jetë pika e cilësuar si informatë mbi rritjen e tatimit në pronë. Nëse ka Gëzimi ndonjë argument le të na e thotë, që ta dimë a ka diçka shtesë që vërtetë të qëndrojë si diskutim, pastaj të nxirren rekomandime apo të shkojmë me informatë.

**Gëzim Sveçla** dha sqarime, duke thënë se argumentet dhe qëllimet tona janë që si pasojë e diskutimit që do të zhvillohet në seancë, do të rekomandohet propozimi ynë, që do të jetë për faljen e 100 €.

**Leutrim Retkoceri** pyeti se kujt i rekomandoni me i falë 100 euro.

**Gëzim Sveçla** tha se i rekomandojmë Qeverisë, por kemi raste që edhe herëve tjera kemi votuar. Rekomandimi ka mbështetje ligjore, për shkak se Qeveria nuk guxon të marrë kurrfarë vendimi pa i dërguar Komuna ndonjë rekomandim, për falje, për pezullim apo për suspendim, për shkak se ato janë të hyra të Komunës, dhe nëse Qeveria i ndalon vetvetiu, atëherë Komuna do të reagojë pse po i ndal të hyrat tona.

**Leutrim Retkoceri** dha sqarime, duke shtruar argumentet pse mendon që kjo pikë duhet të cilësohet si Informatë mbi rritjen e tatimit në pronë.

Po ashtu, tha se të gjitha këto çka i thash mund t'i shkruaj dhe t'ua përcjellë për t'i dërguar në Kuvend.

**Gëzim Sveçla** dha sqarime lidhur me argumentet se mund të qëndrojë si diskutim, duke thënë se është kërkesë që mund ta bëjë Komuna ndaj Qeverisë, që 100 eurot e para në tatim të falen për shkak të krizës ekonomike. Është kompetencë e jona me i rekomanduar Qeverisë që 100 eurot e para t'i zbritni prej tatimit në pronë, pjesa tjetër paguhet. Nëse nuk gabo, të hyra për tatimin në pronë janë të parapara 9 milionë euro.

**Valbona Makolli- Ahmeti** bëri të ditur se janë rreth 11 milionë e gjysmë.

**Mirsad Vitia** tha se si rrjedhojë e atyre diskutimeve besoj që rrjedhin informatat.

**Gëzim Sveçla** u shpreh i pajtimit me mendimin e Leutrim, që tha se duhet me ardhur zyrtarët e Tatimit në Pronë për të na shpjeguar se si ka shkuar procedura.

**Alban Zogaj** u shpreh se ne e japim rekomandimin tonë, ne dalim me rekomandim, por si po e shoh unë na dalin dy rekomandime, një rekomandim i opozitës dhe një i pozitës, mandej e votojmë rekomandimin e pozitës, sepse kemi shumicën në Kuvend, dhe rekomandimi ynë shkon në Ministrinë e Financave, e që është si me bërë pauzë, pezullim deri në vitin 2024, me

kaluar kriza energjetike, kriza ekonomike, kriza e inflacionit, me i informuar qytetarët mirë, me u përgatitur, pastaj në vitin 2024 shkojmë me këtë rivlerësimin e ri dhe ecim tutje.

**Gëzim Sveçla** tha se çfarë po thoni është logjike, mirëpo në këtë rast qytetarit të Prishtinës ne nuk po i ndihmojmë asgjë.

**Alban Zogaj** theksoi se po i ndihmojmë, po e kthejmë siç ka qenë në vitin 2022. Tatimi në pronë është i ulët edhe me vlerësimin e kaluar.

**Gëzim Sveçla**, do të thotë vlerësimi nuk ka qenë real.

**Alban Zogaj** nuk ka qenë real asnjëherë, mirëpo edhe realizimin kur e bën real duhet me e bërë me shkallë.

**Gëzim Sveçla** pyeti nënkryetarin se a pajtoheni që ky është produkt i ligjit, që ligji e ka paraparë vlerësimin pas 3 vjetëve, nuk është faji as i Qeverisë, as i Komunës.

**Alban Zogaj** u shpreh se po, në rregull jemi ne, krejt çfarë po themi është që nuk e ka kohën, koha është totalisht e papërshtatshme, kështu që e pezullojmë, e lëmë për një kohë më të përshtatshme për qytetarët e Prishtinës.

**Gëzim Sveçla** pyeti se pse nuk po shkojmë edhe një hap tutje përpos pezullimit, po ua falim qytetarëve dhe po u ndihmojmë në këtë krizë se kemi mundësi me iu falur si Prishtinë, andaj bashkërisht të gjejmë zgjidhjen si është, të konsultojmë Ministrinë e Financave, askush nuk po humb këtu, vetëm qytetari po përfiton.

**Alban Zogaj** dha sqarime.

**Gëzim Sveçla** theksoi se nëse nuk ndodh falja apo pezullimi, nuk mundeni me i falur për këtë vit, për shkak se nesër nëse Ministri i Financave e fut një nen, ku do të thoshte fali 100 euro, ndonjë komunë mund të thotë pse m'i ndaloni paratë e mija, e ai i thotë po i ndali për shkak të rekomandimit që Kuvendi komunal si organi më i lartë i Komunës ka kërkuar prej meje.

**Leutrim Retkoceri** tha se po kërkon një komunë, por në Kosovë kemi më shumë se 37-38 komuna.

**Gëzim Sveçla** u shpreh, ta bëjmë ne punën tonë si Komunë e Prishtinës, çfarë bëjnë komunitat tjera nuk është punë për ne, secili ka obligim para qytetarëve të vetë.

**Leutrim Retkoceri** tha se ka obligim, por kjo nuk është zgjidhje afatgjate.

**Gëzim Sveçla** shprehu mendimin se zgjidhje afatgjate është vetëm ligji.

**Leutrim Retkoceri** shprehu besimin se Departamenti i Tatimit në Pronë dhe Qeveria mund ta marrin një vendim, që në bazë të ligjit me u kthyer raporti i vitit të kaluar njëjtë siç është i rregulluar me ligj, që Komuna e Prishtinës ka vazhduar me normat e vitit të kaluar.

**Gëzim Sveçla** tha se vetëm Kuvendi mund ta suspendojë një ligj, nuk mundet Qeveria, nuk ka kompetencë, sepse ligji buron prej kuvendit. Ekzekutivi e ka për detyrë me e zbatuar ligjin, vetëm Kuvendi mund ta pezullojë një ligj, nuk mundet Qeveria.

**Leutrim Retkoceri** shprehu mendimin se në rast se shkon sot në Kuvend, unë ju garantoj që suspendohet ligji, sepse është kompetencë që i përket dhe e lehtëson punën.

**Gëzim Sveçla** shprehu mendimin se nënkryetari ishte shumë i qartë, kjo që ka ndodhur është si pasojë e ligjit, pra nuk ka faj as Komuna, as Qeveria, jemi në këtë gjendjen që jemi, të vendosim si është më së miri për qytetarët.

**Fehmi Kupina** pyeti se a po pajtoheni që edhe propozimi i Leutrimit, edhe rekomandimi i Gëzimit të shkojnë si një pikë me e dërguar në Kuvend dhe njëri kalon dhe po e mbyllim këtë temë, pra po e lëmë një pikë.

Osman Bllaca propozoi të jetë "Propozim-diskutimi dhe rekomandim për rritjen e Tatimit në Pronë".

Gëzim Sveçla pyeti a është kthyer diçka prej MAPL-së për prona apo për diçka tjetër.  
Arben Kçira dha sqarime.

Kryesuesi konstatoi se me propozimet e dhëna u miratua ky

### REND I DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dhjetë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit, për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2022 (TM4);
3. Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit, për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2022;
4. Propozimplani vjetor i punës së Kuvendit të Kryeqytetit për vitin 2023;
5. Propozimvendimi për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal;
6. Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje (2023-2025);
7. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit, nr. 01-202/02-10355516/22, dt. 12.05.2022, për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
8. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", SHA, në Prishtinë ;
9. Diskutim për çështjen e tatimit në pronë ;
10. Të ndryshme.

#### Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dhjetë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dhjetë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

#### Pika e dytë

Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit, për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2022 (TM4).

Valbona Makolli - Ahmeti u shpreh se për raportin financiar TM 4, nuk kam çfarë të shtoj, meqenëse është raporti vjetor dhe përfshihet raporti i TM 4. Nëse ju intereson diçka, atëherë mund të përgjigjem.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit, për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2022 (TM4) dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.

## **Pika e tretë**

### **Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit, për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2022.**

Për këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi **Valbona Makolli - Ahmeti**, drejtore, duke thënë se rreth realizimit vjetor të buxhetit për vitin 2022 përqindja është rreth 62% në totalin e buxhetit, kurse sipas kategorive ekonomike, të gjitha kategoritë si paga, mallra, komunali, subvencione janë të gjitha mbi 95%, përveç investimeve kapitale, ku janë diku 25%, kurse për të hyrat vetanake është tejkalimi diku 103% prej të gjitha të hyrave vetanake për këtë vit.

**Mirsad Vitia** pyeti sa është suficiti.

**Valbona Makolli** u përgjigj se suficiti i përafërt duhet të jetë diku 50-51 milionë, se për çdo ditë po ka kthime nga Ministria e Financave, që i ka kthyer banka e jo Ministria, që nuk janë përputhur.

**Gëzim Sveçla** parashtrroi pyetje për raportin e vitit 2021, të cilin e ka përpiluar kjo administratë.

**Valbona Makolli - Ahmeti** u përgjigj, duke thënë se ajo e ka trashëguar dhe është bërë në këtë qeverisje, është një raport që e keni votuar dhe e kemi përshkruar për qeverinë e kaluar.

**Gëzim Sveçla** tha se tek Drejtoria e Investimeve Kapitale, në vitin 2021 kanë qenë të inkorporuara edhe ato mjetet e bartura dhe rrjedhimisht ka rënë përqindja e investimeve, atëherë pse në raportin e këtij viti nuk e keni përfshirë bartjen.

**Valbona Makolli** dha sqarime për këtë çështje.

**Bahri Gashi** tha se raportet që i përgatitni, tabelat që po na i sillni a i bëni në Excel edhe Word, a mund të na i sillni në Exel.

**Valbona Makolli** u përgjigj, duke i thënë se i marrin prej Ministrisë së Financave, mund të zgjedhësh se është edhe në Exel, edhe në Word, pra mundem me ua dërguar në Exel.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit, për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2022 dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.**

## **Pika e katërt**

### **Propozimiplani vjetor i punës së Kuvendit të Kryeqytetit për vitin 2023.**

**Leutrim Retkoceri** tha se mund ta përfshijmë për muajin shkurt në plan të punës propozimin për formimin e komisionit për emërtimin e rrugëve.

**Jeta Rafuna** tha se të njëjtin propozim e pata edhe unë, atë që e propozoj Leutrimi, formimin e komisionit për emërtim dhe riemërtim të rrugëve, kështu që edhe unë pajtohem që për seancën e shkurtit të formohet komisioni për emërtim dhe riemërtim të rrugëve.

**Nora Kelmendi** tha se komisioni që formohet nuk mund të shtojë emra të rrugëve, vetëm në listën rezervë mundet të shtoj emra.

**Kryesuesi** tha se duhet me u formuar një komision, i cili nuk mund të shtoj emra të rrugëve se i ka kaluar afati, por me sa e di unë, mundet në listë rezervë nëse është brenda afatit.

**Milazim Vitija** tha se në vitin e kaluar keni kërkuar që me u formuar ky komision, sepse janë bërë 5 vjet që ky komision nuk funksionon, ka pasur edhe rrugë, d.m.th. emra rezervë, mirëpo

në Prishtinë dhe në periferi ka shumë rrugë të reja, ato rrugë janë të paemërtuara dhe pa adresë.

Ndërsa sa i përket ndryshimit të emrave, ka raste kur në shumë rrugë, banorët e atyre rrugëve janë të pakënaqur, me nënshkrimet e atyre banorëve i drejtohen këtij komisioni dhe komisioni merr vendim me ia ndërruar emrin sipas kërkesës së atyre banorëve, por duhet të jenë mbi 50% të banorëve të asaj lagjeje që kërkojnë të ndryshohet ai emër, pavarësisht se a është në listë rezervë apo jo.

**Bahri Gashi** pyeti se a është komision i përkohshëm apo i përhershëm.

**Gëzim Sveçla** pyeti si mblidhet komisioni, në çka bazoheni, a ka rregullore.

**Osman Bllaca** dha sqarime për pyetjet e parashtruara.

**Valbona Makolli** pyeti për vizitën studimore në Turqi, çfarë është e paraparë në plan të punës.

**Alban Zogaj** tha se edhe herëve të tjera ka qenë në plan të punës, por nuk është realizuar.

**Bahri Gashi** u shpreh se në asamble kam me kërkuar se sa për qind është realizuar plani i vitit 2022 dhe besoj që juve si vlerësues dhe ekipit tuaj u takon me na njoftuar se sa është realizuar ai plan i punës.

Po ashtu, tha se vazhdimisht po përmendet Akademia solemne, unë po mendoj që terminologjia është gabim, sepse në ditët kur janë vlarë njerëzit nuk ka Akademi solemne, por ka Akademi përkujtimore, e kam thënë edhe herën e kaluar, "Epopeja e Jasharëve" është Akademi përkujtimore, jo solemne, mirë është me ndërruar këtë.

Po ashtu, Akademia po mbahet me familjarët e luftëtarëve, ajo duhet të kalojë në kompetencat e Komunës, ne institucionet duhet me e mbajtur atë, jo familjarët, jo bashkëlufëtarët, sepse ajo e ka një kosto dhe ata detyrohen të kërkojnë para për organizim.

Po ashtu, sugjeroi kryesuesin që me shefat apo përfaqësuesit me i vizituar familjet atë ditë, me i nderuar familjarët, por të gjitha po i anashkalojmë dhe pikën kryesore që duhet ta bëjmë nuk po e bëjmë, as vitin e kaluar, as këtë vit.

**Alban Zogaj** u shpreh i pajtimit me parafolësin dhe propozoi të futet në plan.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimplani vjetor i punës së Kuvendit të Kryeqytetit për vitin 2023 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e pestë**

**Propozimvendimi për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal.**

**Alban Zogaj, nënkryetar,** tha se ky Propozimvendim nuk ka asgjë të re, është bashkëpunimi ndërkomunal, që ka ekzistuar edhe më parë, dhe ajo vetëm përsëritet dhe vazhdon, nuk ka diçka të veçantë.

Po ashtu, tha se kryetari Rama ka kërkuar këtë seancë me futur si pikë "Propozimvendim për emërtimin e rrugës "A" në rr. "Xhim Xhema" veprimtarit, lobuesit të madh shqiptaro - amerikan, i cili edhe vjen e viziton Kosovën, më 17 shkurt. Kuvendi komunal e voton, me një fjalë e kalon komisionin dhe voton për emërtimin e rrugës "A" në rr. "Xhim Xhema". Ai ka organizuar një koncert të madh për pavarësinë e Kosovës, më 16 shkurt, do të jetë këtu, i

Faqe 6 nga 8

vendoset emri rrugës dhe e nderojmë një veprimtar të madh, lobues të madh, financues të madh të çështjes së Kosovës, z. "Xhim Xhema".

**Gëzim Sveçla** pyeti se pse kjo urgjencë për dt. 17, kur mundemi të bëjmë një seancë të jashtëzakonshme, nuk është problem.

**Alban Zogaj** tha se mund ta bëjmë edhe me seancë të jashtëzakonshme.

**Valbona Makolli** bëri të ditur se në momentin që po fliste nënkryetari erdhi e-maili, ku thuhet: "Vlerësimi i përgjithshëm për vitin 2023 nuk mund të pezullohet e as të shfuqizohet, pasi tash kanë kaluar tri vjet afat dhe vlerësimi i përgjithshëm, i kryer në 2019, nuk është më i vlefshëm.

**Alban Zogaj** tha atëherë vetëm informata hyn e diskutimi jo.

**Valbona Makolli** bëri të ditur se këtë e-mail ua bashkëngjitë të gjithëve, që në një formë ka thënë që nuk ka as pezullim, as shfuqizim.

**Gëzim Sveçla** tha në rregull, na e thoni nesër në seancë këtë.

**Milazim Vitija**, lidhur me planin vjetor të punës, pajtohem plotësisht me atë çfarë tha Bahriu, ndoshta është harruar se 18 prilli është Ditë e Dëshmorëve të komunës së Prishtinës, aty janë të parapara vizitat tek varrezat e dëshmorëve dhe në mbrëmje, pas të gjitha vizitave, mbahet akademi përkujtimore. Po ashtu, nuk jam në dijeni a është bërë zyra për Shoqatat e dala nga lufta, në kuadër të Komunës, a është duke u promovuar ajo punë apo jo, se me pas qenë ajo këtu ata ishin marrë me atë punë. Le të parashihet në plan të punës Dita e Dëshmorëve të Prishtinës.

**Fehmi Kupina** tha se kryetari është i njoftuar për atë zyrë, por deri ku kanë mbërritur nuk e di. Po ashtu, tha se kryetari e ka propozuar një zyrë lart për Shoqatat e dala nga lufta dhe një zyrtar me qenë, e ata kanë kërkuar të jenë dy e më shumë, e aty kanë ngecur.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimvendimi për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje (2023-2025).**

Për këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi **Premtime Preniqi**. Sa i përket Planit të veprimit të Komunës së Prishtinës, është në harmoni me Planin e veprimit kombëtar. Njëherësh është në harmoni edhe me Konventën e Stambollit, konventë e cila veçse ka hyrë në fuqi në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe shumë shpejt fillojmë me monitorim. Mund të themi se gjysmën e pjesës së monitorimit të strategjisë e ka për implementim niveli lokal, duke e pasur parasysh katër fushat të cilat i parasheh edhe Konventa: parandalim, mbrojtje, ndjekje penale, politikat dhe bashkëpunim.

**Gëzim Sveçla** tha se e kam shikuar materialin i cili na është përcjellë, po më duket vlera e vogël e mjeteve me të cilat dispononi për të realizuar këtë Plan të veprimit.

**Premtime Preniqi** dha sqarime për këtë.

**Gëzim Sveçla** u shpreh se duke e marrë parasysh rëndësinë e punës që e bëni, edhe drejtoresha nëse kishte pasur mundësi me na ndihmuar, me i shikuar aspektet ligjore për të pasur një financim të rregullt, që çështja e financimit mos me paraqitur problem në realizimin e objektivave.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje (2023-2025) dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Të ndryshme**

**Nora Kelmendi** pyeti për pikat e rendit të ditës që janë kthyer nga Ministria dy herë, për këmbime janë, janë tetë, asnjëherë nuk i keni sjellë në kuvend. A e dini se është mbyllur afati, por me të vërtetë humb afati ligjor, 30 ditë i keni pas, a po i ktheni, diku 8-10 i keni, kishte qenë mirë me folur me Doruntinën, me i rregulluar dokumentet ashtu siç i kemi këshilluar dhe me i sjellë në Kuvend, sepse qytetarët po humbasin.

**Arben Kqira** u përgjigj, duke thënë se ne i kemi parë ato dhe besojmë që janë plotësisht të ligjshme.

**Gëzim Sveçla** pyeti se a kanë ardhur dy ftesa për gjykatë.

**Arben Kqira** dha sqarime.

**Gëzim Sveçla** tha Vendimi i fundit për pronën, kur na e keni sjellë dokumentin, na e keni sjellë dokumentin për pronë, e cila ka barrë tatimore, e kjo është vepër penale, kallëzim penal ka me ngritur MAPL për këtë çështje.

**Nora Kelmendi** tha se ne ua kemi kërkuar certifikatat e nuk i keni sjellë, kishin pasur barrë tatimore, për atë nuk i keni sjellë.

**Milazim Vitija** kërkoi nëse ka mundësi që mbledhja e KPF-së dhe seanca me u mbajtur të paktën një javë përpara. Unë e di që jemi dakorduar një herë këtu dhe secili është pajtuar por nuk po ndodhë.

**Fehmi Kupina** tha plotësisht keni të drejtë, është e vërtetë që kësaj rralle ne jemi vonuar, por nuk dëshirova mos me mbajt një mbledhje këtë muaj.

*Mbledhja përfundoi në orën 11:20.*

